

POLITIKA E CILESISE

Trupa certifikuese HVAT shpk siguron një standard të lartë të kryerjes së certifikimit të personelit dhe është e hapur dhe mirëpret ankesat apelimet dhe vërejtjet e aplikuesve, kandidatëve dhe personave të certifikuar lidhur me vendimet e marra nga trupa certifikuese. Trupa certifikuese angazhohet të pajtohet plotësisht me kërkesat e standardit ISO 17024: 2012.

Objektiv kryesor ne aktivitetin e HVAT eshte:

- Garantimi i nje vleresimi te paanshem dhe objektiv te klienteve;
- Promovimi i permiresimit te rendesise se certifikimeve;
- Zbatimin e ligjshmerise dhe standardeve mbi procesin e certifikimit .

Në këtë kontekst, HVAT kontribuon për zhvillimin e një kulture cilësie, përmes kualifikimeve dhe perditësimeve të ekzaminuesve të skemave të ndryshme duke promovuar rritjen e nje sistemi raportesh të bazuar mbi specifika dhe në sigurimin e garancive dhe të besueshmërisë.

Përmes rritjes se kultures se cilesise, HVAT synon të mbështesë dhe të inkurajojë individet/kompanite për përmirësim të vazhdueshëm.

Si një organ i pavarur, HVAT i siguron qasje të lirë për certifikim të gjithë personave që aplikojnë, duke u impenjuar që të mos adoptojë politika dhe procedura diskriminuese ose t'i trajtojë ato në një mënyrë diskriminuese.

Ky angazhim, së bashku me fshehtësinë e të gjithë informacionit dhe transparencës së procedurave të miratuara janë realizuar në përputhje me standartet ndërkombëtare, evropiane dhe shqiptare që rregullojnë aspekte në veprimtarinë e organizmave certifikues, duke siguruar një nivel të shërbimit dhe formë që mund të njihet në çdo vend.

Paanësia në punën tonë është angazhimi Yne.

Periodikisht HVAT verifikon manaxhimin e rreziqeve të mundshme për paanësinë e saj duke informuar të gjithë subjektet e identifikuar dhe duke i ftuar që të njoftojnë për eventuale pozicioni që duhet të vleresohen.

Për të qënë kompetente dhe të njihet si e tillë, HVAT ndjek një politikë të specializimit të lartë në sektorin e saj, duke ndjekur aktivitete të standartizimit, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive në realizimin dhe zbatimin e udhëzimeve për sektorët e kompetencës së saj, në zhvillim dhe në veçanti trajnimin e personelit të saj, dhe çdo realitet tjetër që ka të bëjë me kulturën e cilësisë dhe të vleresimit.

HVAT siguron dallim midis veprimtarisë së certifikimit dhe çdo aktivitet tjetër të kryer në përputhje me objektivat ligjore.

Për zbatimin e qëllimeve statutore, HVAT përdor ;

- aktivitetet e certifikimit.
- organizimin dhe pjesëmarrjen në ngjarje, konferenca, kongrese dhe seminare;
- promovimin e studimeve të shumta mbi çështje të veçanta, në bashkëpunim me agjencitë e tjera.

Të paktën çdo vit, do të marrë pjesë në kontrollin e dokumentave të aktiviteteve të certifikimit të realizuara nga HVAT mbi veprimtarinë e tij, dhe konfrontimi me rezultatet me planin e përmirësimit të cilësisë, ku është e mundur me tregues të matshëm.

Si Administrator kam përgjegjësinë për përcaktimin dhe zbatimin e këtyre planeve, të paktën një herë vit, duke vendosur veprimet korrigjuese të nevojshme.

Ankesat dhe kontestimet lidhur me manaxhimin e certifikimeve ose ndonjë aktiviteti tjetër dhe që nuk janë zgjidhur duke përdorur strukturat organizative ekzistuese, vendosen nën kujdesin e komiteteve teknike dhe është impenjimi im në ndjekjen dhe përbërjen e tyre.

Tirane, me 06.01.2019

Administrator HVAT

